

ÇFARË JANË MARTESAT NË MOSHË TË HERSHME?

Të martohesh në moshë të hershme do të thotë të martohesh pa mbushur 18 vjeç, pavarësisht nëse është një martesë zyrtare apo një martesë fakti.

PSE VESHE FUSTAN TË BARDHË APO KOSTUM DHËNDËRIE, PSE VUTË UNAZA NË GISHT APO KËRCYET NË DASMË, PSE JENI TË MARTUAR NË SYTË E NJERËZVE TUAJ, NUK DO TË THOTË QË SHIHENI SI TË MARTUAR NË SY TË LIGJIT APO SHTETIT.

Gjykata mund ta lejojë këtë martesë vetëm për shkaqe me rëndësi.

A e dini se...

Shumë ligje shqiptare dhe ndërkombëtare mbrojnë të drejtat e tua si fëmijë dhe ndalojnë kryerjen e marrëdhënieve seksuale me fëmijë që nuk kanë mbushur 14 vjeç. Po ashtu, e dënojnë me burg një person që kryen marrëdhënie me ty pa dëshirën dhe pëlqimin tënd, edhe sikur të kesh mbushur 14 vjeç.

Disa prej këtyre ligjeve janë:

- ❖ Kushtetuta;
- ❖ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;
- ❖ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- ❖ Kodi i Familjes;
- ❖ Kodi Penal;
- ❖ Kodi Civil;
- ❖ Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës;
- ❖ Ligji për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.

KUJDES!

Premtimet për një jetë si VIP Instagrami nuk janë gjithmonë të vërteta.

Ti ke të drejtën për të pasur një fëmijëri. Askush nuk duhet të ta heqë këtë të drejtë, madje as prindërit apo i dashuri/e dashura jote. Kur të rritesh do të kesh të drejta, mundësi dhe përgjegjësi të tjera por fëmijëria nuk të përsëritet më!

NË SHQIPËRI

11%
e vajzave



janë në një martesë, fejesë a bashkëjetesë

2%
e djemve



32%
të rasteve



ndryshimi i moshës mes vajzës dhe burrit është 7-10 vjet

ÇFARË MUND TË NDODHË NËSE MARTOHESH KUR JE ENDE FËMIJË?

- ❖ Ti ke më tepër gjasa të braktisësh shkollën, sesa bashkëmoshatarët e tu;
- ❖ Do takosh më rrallë shokët dhe shoqet;
- ❖ Nuk do të kesh më kohë të pushosh, të luash dhe të argëtohesh;
- ❖ Do përdorësh më pak rrjetet sociale, ose ka të ngjarë që burri a familjarët e tij të të kontrollojnë telefonin dhe mesazhet e tua;
- ❖ Mund të humbasësh më shumë se 50 festa e ditëlindje;
- ❖ Mbrëmja e maturës do të mbetet veçse një ëndërr për ty;
- ❖ Mund të bëhesh nënë duke qenë vetë fëmijë, gjë që dëmton shëndetin e trupit dhe mendjes;
- ❖ Mund të ndodhë që vjehrra jote ta regjistrojë fëmijën sikur e ka të vetin. Kështu në sytë e shtetit mund të mos shihesh si nëna e fëmijës, duke mos marrë dot përkrahjen e duhur, ose duke mos marrë vendime për fëmijën tënd;
- ❖ Rrezikohesh më shumë se kushdo nga papunësia, ose ke shumë gjasa që të bësh punë të rënda për moshën tënde, të papaguara ose shumë pak të paguara;
- ❖ Martesa jote rrezikon më shumë se të tjerat që të zgjidhet;
- ❖ Bashkëjetuesi mund të kthehet në trafikantin a keqbërësin tënd që mund të të shfrytëzojë për punë, lypje, prostitucion, për krime, apo për të marrë mbiemrin tënd që të humbë gjurmët e krimeve që ka kryer vetë më parë.

Pyet veten:

- ▶ A do të jetë kjo marrëdhënie vërtet e barabartë për ju si çift?
- ▶ A do të kesh forcën për të pasur një zë të barabartë në këtë martesë, apo për të marrë vendime për jetën tënde?
- ▶ Para se të marrësh vendimin më të rëndësishëm të jetës tënde, bëj një listë me arsyet pse duhet t'i thuash 'Po' ose 'Jo' fejesës, martesës a bashkëjetesës.



RRETH PROJEKTIT

Kjo fletëpalosje u zhvillua në kuadër të programit

"TRANSFORMIMI I PËRGJIGJES

KOMBËTARE NDAJ TRAFIKIMIT

TË QENIEVE NJERËZORE

NË DHE NGA SHQIPËRIA"

implementuar nga Qendra Europiane,
udhëhequr nga UNICEF Albania dhe mbështetur
nga British Embassy Tirana.

**KENI MENDIME TË TJERA
SE SI MUND TË LUFTONI
PABARAZINË GJINORE DHE
PRAKTIKAT E DËMSHME,
SI MARTESAT E HERSHME?**

NA SHKRUANI NË:



FONDACIONI QENDRA EUROPIANE

Rr. "Vaso Pasha" P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri
info@euro-centre.eu
www.euro-centre.eu

DISA MËNYRA SI TË MBROHESH DHE TË LUFTOSH MARTESËN E FËMIJËVE PËRRETH TEJE

- ❖ Komunikoni me prindërit dhe/ose me të dashurin/ën për t'ju shpjeguar pse martesat nuk është zgjidhja më e mirë për ty tani për tani;
- ❖ Drejtohu për ndihmë tek njerëzit që ju beson, p.sh. një i afërm apo profesionistët që kujdesen për ty;
- ❖ Kontakto me mësuesin/en kujdestar/e, psikologun/en e shkollës, ose mjekun e familjes;
- ❖ Lexo dhe edukohu mbi të drejtat dhe liritë e tua;
- ❖ Krijoni një grup mbështetës për fëmijët që rrezikohen nga martesat e hershme apo janë tashmë të martuar që ata/ato të vijojnë të jenë pjesë e jetës shkollore dhe veprimtarive rinore;
- ❖ Kërko nga pika fokale e barazisë gjinore në shkollën tënde që të bashkë organizoni veprimtari tematike për barazinë mes vajzave e djemve, grave e burrave, për çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore dhe praktikave të dëmshme siç është martesat apo bashkimi në moshë të hershme, për rreziqet e trafikimit, për mosdiskriminimin, apo për rëndësinë e qëndrimit në shkollë;
- ❖ Gjeni listën e organizatave të shoqërisë civile në zonën tuaj dhe bashkëpunoni me to;
- ❖ Gjej punonjës të mbrojtjes së fëmijës në zonën tuaj në faqen <http://femijet.gov.al/al/njesite-per-mbrojtjen-e-femijeve>.

KONTAKTO LINJËN KOMBËTARE
KUNDËR TRAFIKIMIT **116 006**

KONTAKTO LINJËN FALAS PËR FËMIJË **ALO 116 111**

KONTAKTO POLICINË E SHTETIT **129**

KËRKO NDIHMË LIGJORE FALAS **0800 1010**

MARTESAT NË MOSHË TË HERSHME I JAPIN FUND FËMIJËRISË

Kjo fletëpalosje është për ju, vajza dhe djem që duhet të arsimoheni, edukoheni dhe gëzoni fëmijërinë tuaj, si dhe që doni të jeni aktivë në bashkësitë tuaja.